

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË

**Rivlerësim i përparimit në hartimin dhe zbatimin e
kornizës ligjore dhe të politikave për riintegrimin e
personave të riatdhesuar**

Janar, 2014

Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. HYRJE	5
2. PËRMBLEDHJE E KORNIZËS LIGJORE, TË POLITIKAVE, RREGULLATORE DHE INSTITUCIONALE PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR	7
2.1 Niveli qendror	8
1) <i>Bordi për Riintegrim</i>	8
2) <i>Zyra për Riintegrim</i>	9
2.2 Niveli komunal.....	10
1) <i>Zyrat komunale për komunitete dhe kthim</i>	10
2) <i>Komisionet komunale për riintegrim</i>	11
3. ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE POLITIKE NË NIVEL QENDROR DHE ATË KOMUNAL	12
3.1 Niveli qendror	12
1) <i>Bordi i riintegrimit</i>	12
2) <i>Zyra për riintegrim</i>	13
3.2 Niveli komunal.....	15
1) <i>Zyrat komunale për komunitete dhe kthim</i>	15
2) <i>Komisionet komunale për riintegrim</i>	16
3) <i>Nismat e përbashkëta ZKKK-KKR</i>	18
3.3 Përmbledhje e gjetjeve	18
4. RISHIKIMI I KORNIZËS SË RIINTEGRIMIT MË 2013	20
4.1 Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar 2013, si dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj	20
4.2 Rregullorja 20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit	22
5. KONKLUDIME	23
6. REKOMANDIMET	25

SHKURTESAT

KQR	Komisioni Qendror për Riintegrim
KiE	Këshilli i Evropës
SMR	Sistemi i menaxhimit të rasteve
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
PNDESK	Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
ZKKK	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
KKR	Komisionet komunale për riintegrim
OSBE	Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNICEF	Fondi i Fëmijëve i OKB-së
UNHCR	Komisari i Lartë i OKB-së për Refugjatë
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport shqyrton përparimin e arritur nga institucionet e Kosovës në hartimin dhe zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Raporti vijon nga një raport i mëparshëm i OSBE-së, me titull “*Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës*”, i publikuar në shtator 2011, përmes të cilit është bërë një vlerësim për periudhën janar 2010 deri në korrik 2011. Ai analizon shkallën në të cilën rishikimi i kornizës rregulluese në vitin 2012 ia doli mbanë që t’i adresojë mangësitë e identifikuara, dhe monitoron respektimin e obligimeve kyçe të politikave nga niveli qendror dhe ai komunal. Gjithashtu, ai i shqyrton reformat e fundit të politikave në vitin 2013 për efikasitetin e tyre të mundshëm në përmirësimin e kornizës institucionale për menaxhim të programit të riintegrit, duke u përqendruar veçanërisht në qëndrueshmërinë e ndihmës për riintegrim.

Raporti konstaton se është bërë përparim i dukshëm që nga viti 2011. Institucionet përgjegjëse kanë vazhduar të jenë të përkushtuara ndaj procesit të riintegrit, siç dëshmohet nga ndarja e vazhdueshme e burimeve të konsiderueshme njerëzore dhe financiare. Ndryshimet institucionale kanë qenë deri diku të suksesshme në adresimin e problemeve të identifikuara: në vitin 2012, decentralizimi i pjesshëm i fondit çoi në rritje të pagesës së ndihmës për riintegrim, ndërsa emërimi i koordinatorëve rajonalë fuqizoi bashkëpunimin e dobët mes nivelit qendror dhe atij lokal. Reforma e politikave e vitit 2013 i çoi përpara këto suksese duke ristrukturuar procesin e aprovimit në nivel qendror dhe duke propozuar mekanizma të rinj proceduralë me qëllim të përsheptimit të shqyrtimit të kërkesave. Ç’ është më e rëndësishme, ajo hapi fondin për palë të treta që mëtonin të zbatonin projekte afatmesme deri afatgjata në dobi të personave të riatdhesuar, duke e shndërruar ndihmën e drejtpërdrejtë në masa më të qëndrueshme që adresonin problemet kryesore në arsim dhe punësim.

Megjithatë, për shkak të mungesës të vazhdueshme të të dhënave të besueshme e të centralizuara vazhdon të jetë i pamundshëm vlerësimi sasior i gjendjes së personave të riatdhesuar në Kosovë dhe ndikimit që kanë pasur politikën në riintegrimin e tyre. Pa informacion të saktë rreth numrit të individëve që kanë qasje në shërbime publike bazë, siç janë strehimi apo arsimit, është tepër vështirë të bëhet planifikim apo monitorim efektiv i politikave dhe projekteve të riintegrit. Sfidat tjera të vazhdueshme përfshijnë mungesën e monitorimit dhe raportimit rreth zbatimit të ndihmës, dhe një qasje kryesisht reaguese nga shumë komuna për të shkuar më afër personave të riatdhesuar për identifikimin e nevojave të tyre dhe informimin e tyre për ndihmat në dispozicion. Ndonëse strategjia e re i adreson këto çështje në letër, mbetet të shihet nëse korniza e përmirësuar e politikave do të arrijë që të përkthehet në përparim konkret në terren.

OSBE inkurajon të gjitha institucionet qendrore dhe komunale që t’i vazhdojnë përpjekjet e tyre në përkrahje të riintegrit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Institucionet e nivelit qendror duhet të prioritetizojnë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një baze gjithëpërfshirëse të të dhënave për personat e riatdhesuar, dhe t’i përdorin informacionet rezultuese për ta menaxhuar dhe vlerësuar dhënien e ndihmës për riintegrim. Institucionet komunale duhet të vazhdojnë që të punojnë se

bashku për t'i identifikuar nevojat e personave të riatdhesuar dhe për të rritur vetëdijen për fondet në dispozicion, përfshirë përmes aktiviteteve të rregullta të komunikimit me personat e riatdhesuar dhe nismave të tjera të synuara. Të gjithë akterët gjegjësisht duhet të punojnë bashkë për të kërkuar, hartuar, zbatuar dhe vlerësuar projekte të riintegritit që përqendrohen në dobitë në afat të mesëm dhe të gjatë për personat e riatdhesuar.

1. HYRJE

Që nga janari 2005 deri në fund të qershorit 2013, në Kosovë janë kthyer me forcë apo janë “riatdhesuar”¹ rreth 25,000 deri 27,000 persona, me një mesatare prej 2,500 deri 3,500 persona në vit.² Që nga viti 2008, marrëveshjet dypalëshe të ripranimit të lidhura mes Kosovës dhe 21 shteteve të Evropës Perëndimore kanë riafirmuar shprehimisht të drejtën e shteteve nënshkruese për t’i riatdhesuar pa vullnetin e tyre personat të cilët nuk i plotësojnë kushtet e hyrjes, qëndrimit ose banimit në territorin e tyre, dhe detyrën e institucioneve të Kosovës për ripranimin e tyre “pa formalitete të mëtejme”.³

Përveç stresit psikologjik që shoqëron kthimin e detyrueshëm⁴, personat e riatdhesuar shpesh përballen me vështirësi për t’i gëzuar të drejtat dhe shërbimet themelore, duke përfshirë regjistrimin civil, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe asistencën sociale, dhe për të gjetur vende të qëndrueshme pune. Shkathësitë gjuhësore të fëmijëve të riatdhesuar të cilët janë lindur dhe rritur jashtë vendit janë shpesh më të dobëta sesa ato të bashkëmoshatarëve të tyre të lindur në Kosovë, duke ua bërë të vështirë që të zënë hapin me fëmijët e tjerë. Pas vitesh të tëra të jetesës në mërgim, shumë të rritur të riatdhesuar nuk as kontakte dhe as përvojën profesionale për të konkurruar me

¹ Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar përkufizon “riatdhesimin” si “veprim i kthimit në Kosovë i realizuar nga një qytetar i Kosovës apo një qytetar me origjinë nga Kosova dhe aplikohet në të gjitha llojet e kthimit në rastin kur hyrja në territorin e Kosovës bëhet përmes një pike zyrtare të kalimit kufitar”. Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), 11 tetor 2013.

² Të dhënat e mbledhura nga Komisari i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR) tregojnë që mes janarit 2005 dhe fundit të shtatorit 2013 janë riatdhesuar 25,052 persona, me një mesatare prej rreth 2,950 në vit (3,554 në 2005, 3,569 në 2006, 3,219 në 2007, 2,550 në 2008, 2,962 në 2009, 2,910 në 2010, 2,435 në 2011, 2,516 në 2012, 2,349 prej janarit deri në fund të shtatorit 2013). Pasqyrë statistikore e UNHCR, e përditësuar në fund të shtatorit 2013. Shifrat e qeverisë për po të njëjtën periudhë janë gjithsej 27,185 persona, me një numër mesatar prej 3,200 personash / vit (4,987 në 2005, 3,278 në 2006, 2,945 në 2007, 2,556 në 2008, 3,225 në 2009, 3,095 në 2010, 2,715 në 2011, 2,920 në 2013 dhe 1,464 deri në fund të qershorit 2013). Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM) në kuadër të MPB-së, “Numri i të ripranuarve, vullnetarë dhe të detyrueshëm, mes janarit 2005 dhe qershorit 2013”.

³ Këto 21 shtete janë: Shqipëria, Austria, Belgjika, Bullgaria, Republika e Çekisë, Kroacia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Hungaria, Lihtenshtajni, Luksemburgu, Malta, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Sllovenia, Suedia dhe Zvicra, ndërsa po negociohen edhe marrëveshja tjera. Mbaj parasysh që Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu (shtetet e Beneluksit) janë përfshirë në një marrëveshje të vetme. Zyrtar i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), MPB, intervistë individuale, 4 shtator 2013. Termat “pa formalitete të mëtejme”, “pa asnjë formalitet” dhe “pa formalitete” janë hasur në të gjitha marrëveshjet që janë në dispozicion në internet, përveç asaj të negociuar me Francën. Ministria e Punëve të Jashtme, “Marrëveshjet ndërkombëtare”, <http://www.mfa-ks.net/?page=2,72> (30 shtator 2013).

⁴ Për vlerësim gjithëpërfshirës të ndikimit negativ psikosocial të riatdhesimit të fëmijët nga komunitetet në pozitë të cenueshme, shih raportet e Fondit të Fëmijëve të OKB-së (UNICEF): UNICEF-i në Kosovë dhe Komisioni Gjerman për UNICEF-in, *Asnjë vend që mund ta quajnë shtëpi: Riatdhesimi nga Gjermania në Kosovë ashtu siç e shohin dhe e përjetojnë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë*, gusht 2011, http://www.unicef.org/kosovo/No_Place_to_Call_Home_English_2011.pdf (qasur më 30 dhjetor 2013); dhe UNICEF-i në Kosovë në bashkëpunim me Fondacionin Kosovar për Shëndetësi, *E keqja e heshtur: Raport që vlerëson gjendjen e shëndetit psikosocial të fëmijëve të riatdhesuar*, mars 2012, http://www.unicef.org/kosovo/SILENT_HARM_Eng_Web.pdf (qasur më 30 dhjetor 2013).

sukses për ato pak vende të lira pune, dhe, në vend të kësaj, varen nga përkrahja e anëtarëve të familjes ose miqve. Afërsisht një e katërta e personave të riatdhesuar u takojnë komuniteteve që Komisari i Lartë për Refugjatë (UNHCR) i konsideron si "në rrezik" dhe në nevojë të mbrojtjes ndërkombëtare⁵, gjegjësisht serbë të Kosovës, shqiptarë të Kosovës në pakicë numerike në nivel komunal, dhe anëtarë të komunitetit egjiptian, rom dhe ashkali të Kosovës, dhe mund të përballen me kufizime në lirinë e tyre të lëvizjes, si dhe kërcënime reale apo të perceptuara ndaj sigurisë së tyre.

Si pjesë e mandatit të tij të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe të kthyerve në Kosovë, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) nxjerr rregullisht raporte publike lidhur me kushtet për pranimin dhe riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë, duke u përqendruar veçanërisht në respektimin e detyrimeve ligjore dhe të politikave nga ana e institucioneve.⁶ Një raport i OSBE-së i vitit 2009, kishte konkluduar që "masat konkrete për lehtësimin e procesit të riintegrimit të personave të riatdhesuar ende mungonin në fushat kyçe të shëndetësisë, arsimit, punësimit dhe banimit", dhe se komunave u mungonin fondet për riintegrim; ai gjithashtu kishte vënë në dukje mungesën e mekanizmave të referimit dhe të bashkërendimit mes institucioneve përkatëse qendrore dhe lokale.⁷ Ndonëse një raport tjetër pasues i vitit 2011 nënvizonte disa zhvillime pozitive, duke përfshirë këtu krijimin e një fondi qendror bukur të madh për riintegrim dhe një bashkërendim institucional më të madh, megjithatë, ai raportonte prapë për zbatim të dobët në kuptim të mbledhjes së të dhënave, monitorimit dhe raportimit, veçanërisht në nivelin lokal.

Ky raport shqyrton përparimin e arritur në procesin e riintegrimit qysh prej botimit të vlerësimit të vitit 2011. Meqë mungesa e vazhdueshme e të dhënave të besueshme rreth personave të riatdhesuar vazhdon ta bëjë shumë problematik realizimin e çfarëdo vlerësimi sasior të përpjekjeve për riintegrim, analiza përqendrohet prapë në statusin e zbatimit të kornizës ligjore dhe asaj të politikave.⁸ Për këtë qëllim, Pjesa 2 shqyrton zhvillimet në këtë kornizë mes korrikut 2011 dhe qershorit 2013, duke vënë në pah vendimin e vitit 2012 për ta decentralizuar pjesërisht fondin për riintegrim te komunat përmes themelimit të komisioneve komunale për riintegrim (KKR) dhe emërimit të koordinatorëve rajonalë. Pastaj, Pjesa 3 vlerëson statusin aktual të zbatimit të kësaj kornize nga Bordi për Riintegrim dhe Zyra për Riintegrim në nivel qendror, dhe zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) dhe KKR-të në nivel lokal. Përmbledhja e gjetjeve do të shqyrtojë shkallën në të cilën zhvillimet përkojnë me rekomandimet e raportit të vitit 2011 të OSBE-së. Pjesa 4 përqendrohet në procesin e vazhdueshëm të rishikimit të kornizës së politikave dhe asaj rregullatore për riintegrimin e personave të riatdhesuar, duke vlerësuar efektshmërinë e mundshme të ndryshimeve në adresimin e mangësive të identifikuara. Në fund, raporti jep disa përfundime të përgjithshme dhe paraqet një sërë rekomandimesh me synim rritjen e respektimit të

⁵ Gjithsej 21.31 për qind në 2011, 27.02 për qind në 2012, dhe 25.75 për qind mes janarit dhe shtatorit 2013. Pasqyrë statistikore e UNHCR-it, e përditësuar në fund të shtatorit 2013. Dy të tretat e tyre i përkasin komunitetit rom të Kosovës (65.08 për qind).

⁶ Raporti i OSBE-së "Zbatimi i Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës", nëntor 2009, <http://www.osce.org/kosovo/40180> (qasur më 30 dhjetor 2013) (Raporti i 2009 për riatdhesimin); Raporti i OSBE-së "Vlerësimi i përparimit në zbatimin e kornizës së politikave për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunat e Kosovës", shtator 2011, <http://www.osce.org/kosovo/82416> (qasur më 30 dhjetor 2013) (Raporti i 2011 për riatdhesimin).

⁷ Raporti i 2009 për riatdhesimin, f. 1.

⁸ Raporti i 2011 për riatdhesimin, f. 3.

detyrimeve për riintegrim nga ana e institucioneve përgjegjëse dhe përmirësimin e kushteve në terren për personat e riatdhesuar.

Sa i përket metodologjisë, raporti shfrytëzon një kombinim të të dhënave cilësore dhe sasiore që OSBE-ja i ka mbledhur nëpërmjet aktiviteteve të rregullta të monitorimit në 34 komuna⁹ prej korrikut 2011 deri në qershor 2013. Informacioni është mbledhur gjithashtu edhe nëpërmjet intervistave në telefon ose atyre individuale me 54 zyrtarë komunalë nga 34 komuna duke përfshirë përfaqësues nga ZKKK-të dhe KKR-të, koordinatorët rajonalë, si dhe përfaqësues nga Departamenti për Riintegrim dhe Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) (paraqitur më hollësisht në fusnotat më poshtë). Veç kësaj, informatat janë mbledhur nëpërmjet kontakteve të rregullta me përfaqësues të komuniteteve dhe organizatave ndërkombëtare e vendore që punojnë në fushën e riatdhesimit. Intervistat me zyrtarët komunalë u zhvilluan mes 1 dhe 15 korrikut 2013, ndërsa intervistat me zyrtarë të nivelit qendror u zhvilluan mes 29 gushtit dhe 14 tetorit 2013. Vlerësimi përfshin të dhëna sasiore rreth kërkesave të paraqitura për ndihmë, të klasifikuara sipas llojit të ndihmës; të dhëna sasiore rreth themelimit të organeve të zbatimit në nivel lokal dhe qendror, të klasifikuara sipas komunave, të dhëna sasiore dhe cilësore për funksionimin efektiv të institucioneve përkatëse, veçanërisht në lidhje me (i) respektimin e përgjegjësiave të tyre të monitorimit, të raportimit, të mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave dhe (ii) nismat komunale për përkrahje të riintegrit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar .

2. PËRMBLEDHJE E KORNIZËS LIGJORE, TË POLITIKAVE, RREGULLATORE DHE INSTITUCIONALE PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHE SUAR

Instrumenti ndërkombëtar më i plotë mbi ripranimin është *Njëzet udhëzimet e Këshillit të Evropës për kthimin e detyrueshëm* i vitit 2005,¹⁰ që saktëson detyrimet e shteteve dërguese dhe pranuese gjatë fazave të hershme të largimit dhe ripranimit të të kthyerve me forcë. Megjithatë, pak është bërë në kuptim të standardeve të pranuar lidhur me procesin pasues të riintegrit, ndonëse personat e riatdhesuar kanë të njëjtat të drejta të njeriut sikurse gjithë të tjerët, duke përfshirë qasjen në arsim, kujdes shëndetësor dhe ndihmë sociale.¹¹ Këto të drejta garantohen dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme me kornizën ligjore të Kosovës.¹²

⁹ Raporti nuk përfshin katër komunitat veriore të Mitrovica/Mitrovicës Veriore Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zvečan/Zveçanit, meqenëse këto komuna nuk e kanë zbatuar kornizën rregullatore e politike të riintegrit.

¹⁰ Këshilli i Evropës (KiE), *Njëzet udhëzime për kthimin e detyrueshëm*, shtator 2005 (“Udhëzimet e KiE”). <http://www.refworld.org/docid/42ef32984.html> (qasur më 30 dhjetor 2013).

¹¹ Neni 22 (e drejta në sigurim social), neni 23 (mbrojtja nga papunësia), neni 25 (e drejta në shëndet) dhe neni 26 (e drejta në arsimin) i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, Rezoluta 217 A (III) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, 10 dhjetor 1948 (DUDNJ). Gjithashtu, neni 13 (e drejta në arsim) dhe neni 12 (e drejta në kujdes shëndetësor) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturale (PNDESK), Rezoluta 2200A (XXI) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, 16 dhjetor 1966, që ka hyrë në fuqi më 3 janar 1976.

¹² Shih gjithashtu: Ligji nr. 2011/04-L-032 për Arsimin parauniversitar, 31 gusht 2011; Ligji nr. 2012/04-L-125 për Shëndetësi, 26 prill 2013; Ligji nr. 2003/15 për Skemën e ndihmës sociale në Kosovë, 18 gusht 2003 dhe Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e ndihmës sociale në Kosovë, 20 maj 2012.

Në Kosovë, përgjegjësinë për sigurimin e respektimit të standardeve ndërkombëtare gjatë procesit të ripranimit - sidomos parimet e unitetit të familjes, gjendjes shëndetësore dhe dinjitetit e sigurisë – e bartë kryesisht shteti dërgues,¹³ derisa legjisllacioni i Kosovës kufizohet në përshkrimin e kriterëve bazë që duhen plotësuar për t'u ripranuar (statusi ligjor ose plotësimi i kushteve për status ligjor në Kosovë dhe statusi i parregullt në shtetin pritës).¹⁴ Megjithatë, pasi që të ripranohen nga Kosova, personat e riatdhesuar janë të mbrojtur nga një politikë gjithëpërfshirëse dhe kornizë rregullatore që u jep atyre një mori të drejtash dhe shërbimesh. Deri në shtator 2013, dokumentet kyçe ishin Strategjia e rishikuar për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe Plani gjegjës i veprimit (Strategjia dhe Plani i veprimit i 2010), të miratuara përkatësisht në prill dhe gusht 2010, dhe Rregullorja nr. 10/2012 për menaxhimin e programit për riintegrim, e miratuar në korrik 2012 (Rregullorja 10/2012); së bashku, këtyre u referohet si "korniza 2010/2012". Në shkurt 2013 qeveria nisi një rishikim të kornizës së politikave dhe asaj rregullatore, në përpjekje për të vlerësuar dhënien e ndihmës për riintegrim dhe për të përmirësuar efikasitetin e kornizës institucionale. Kjo rezultoi në miratimin e një rregulloreje të re më 6 shtator,¹⁵ dhe një strategjie e plani të ri të veprimit më 11 tetor 2013, së bashku, këtyre u referohet si "korniza e 2013-ës". Gjersa Pjesët 2 dhe 3 përqendrohen në kornizën 2010/2012 dhe zbatimin të saj nga institucionet qendrore dhe komunale, Pjesa 4 shqyrton ndryshimet e paraqitura me kornizën e 2013-ës dhe potencialin e saj për të adresuar mangësitë në kornizën e mëparshme dhe në zbatimin e saj.

Një tjetër dokument i rëndësishëm, që ka të bëjë si me kornizën e 2010/2012 ashtu edhe atë të 2013-ës, është Rregullorja nr. 02/2010 për zyrat komunale për komunitete dhe kthim (Rregullorja 02/2010)¹⁶ Kjo rregullore përcaktonte krijimin e mekanizmave lokal të bashkërendimit për çështje të kthimit dhe të komuniteteve në gjithë komunat, për të shërbyer si akterë kryesorë me përgjegjësinë për krijimin e politikave të suksesshme të kthimit dhe riintegrimin në nivel lokal, si dhe për zbatimin e nismave të riintegrimin dhe zhvillimit që krijojnë kushte të favorshme për kthim të qëndrueshëm, veçanërisht në kuptim të garantimit të qasjes në të drejtat dhe shërbimet themelore, duke përfshirë këtu të drejtat pronësore, kujdesin shëndetësor, arsimin dhe punësimin.

2.1 Niveli qendror

Sipas kornizës 2010/2012, bartës kryesor në nivel qendror të detyrës për Riintegrim ishin Bordi për Riintegrim, një organ ndërministror ky me përgjegjësi të gjithmbarshme për menaxhimin e programit të riintegrimin, dhe Zyra për Riintegrim, që i ofronte Bordit për Riintegrim përkrahje administrative dhe teknike.

1) Bordi për Riintegrim

Në prill të vitit 2010, qeveria themeloi një Bord ndërministror për Riintegrim si organin më të lartë përgjegjës për të menaxhuar programin për riintegrimin e

¹³ Udhëzimet e KiE, 11, 16 dhe 17, shënimi 10 më sipër.

¹⁴ Ligji nr. 03/L-208 për ripranimin, 12 korrik 2010.

¹⁵ Rregullorja nr. 20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit për riintegrim, 6 shtator 2013.

¹⁶ Zyra e Kryeministrit, 12 gusht 2010.

personave të riatdhesuar,¹⁷ në përbërje të përfaqësuesve të lartë të ministrive kyçe¹⁸, si dhe disa vëzhguesve ndërkombëtarë.¹⁹ Ai përkrahej nga një Sekretariat dhe Zyrë për Riintegrim me orar të plotë, me lokacion në MPB.²⁰

Fillimisht, Bordi për Riintegrim ishte organi i vetëm me autoritetin për të miratuar kërkesa për ndihmë në riintegrim, duke përfshirë këtu edhe kërkesat më të vogla për pako ushqimore, orendi dhe dru zjarri. Megjithatë, me rritjen e numrit të kërkesave kjo punë u bë gjithnjë e më e rëndë, dhe Rregullorja nr. 10/2012 i barti nivelit komunal përgjegjësinë për miratimin e kërkesave për artikuj ushqimorë dhe joushqimorë dhe ndihma të tjera urgjente (shih Pjesën 2.2.2 më poshtë). Bordi për Riintegrim ruajti kompetencën ekskluzive për të vendosur për kërkesat për ndërtim apo rindërtim të banesave dhe për projekte të gjenerimit të të ardhurave,²¹ të cilat shqyrtohen në baza mujore ose në takime *ad hoc*.²²

Bordi për Riintegrim kishte gjithashtu përgjegjësinë kryesore për të mbikëqyrur zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit të 2010-ës, dhe për të informuar qeverinë për tërë përparimin përkatës dhe sfidat e identifikuara.²³ Ai kishte për detyrë të përcaktonte përgjegjësitë dhe të lehtësonte shpërndarjen e informacionit, si horizontalisht mes ministrive ashtu edhe vertikalisht mes nivelit qendror dhe lokal, si dhe për bashkëpunimin me donatorët dhe komunitetin ndërkombëtar në projekte dhe nisma të riintegrit.²⁴

2) Zyra për Riintegrim²⁵

Zyra për Riintegrim ishte pikë kontakti për çështje të riintegrit në nivel qendror dhe pikë kryesore e kontaktit për komunat. Ajo kishte për detyrë që Bordit për Riintegrim dhe Sekretariatit të tij t'u jepte përkrahje të përgjithshme administrative, të bënte verifikimin paraprak të kërkesave për ndihmë para se t'ia dorëzonte ato Sekretariatit, dhe që ta monitoronte zbatimin e vendimeve të Bordit për Riintegrim dhe të KKR-ve.²⁶ Veç kësaj, ajo ishte përgjegjëse edhe për të mbledhur informacione personale rreth personave të riatdhesuar, përfshirë këtu informacionet nga komunat, dhe për t'i regjistruar e menaxhuar këto të dhëna në nivel qendror.²⁷

Në kuptim të komunikimit dhe bashkërendimit komunal, Zyra për Riintegrim ishte përgjegjëse për menaxhimin e rrjedhjes së informacionit te komunat, duke përfshirë

¹⁷ Vendim nr. 7/123 i qeverisë, 30 prill 2010; Strategjia e 2010-ës, neni 7.

¹⁸ Ato janë MBP; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria për Komunitete dhe Kthim; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; dhe Zyrës së Kryeministrit.

¹⁹ Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe UNHCR-i.

²⁰ Rregullorja nr. 10/2012, nenet 7.1.10, 8 dhe 9.2.6.

²¹ Rregullorja nr. 10/2012, nenet 9.2.2 dhe 8.2.3.

²² Rregullorja nr. 10/2012, nenet 9.2.9.

²³ Rregullorja nr. 10/2012, nenet 9.2.1, 9.2.10 dhe 9.2.12.

²⁴ Rregullorja nr. 10/2012, nenet 9.2.3, 9.2.5 dhe 9.2.12, si dhe 9.2.11.

²⁵ Mbani parasysh Rregulloren nr. 20/2013 e zgjeruar Zyrën për Riintegrim në Departament për Riintegrim. Megjithatë, meqë periudha e raportimit për këtë pjesë është para miratimit të rregullores së re, gjithë referencat u bëhen ish-Zyrës për Riintegrim.

²⁶ Rregullorja nr. 10/2012, nenet 7.1.10, 7.1.9 dhe 7.1.12.

²⁷ Rregullorja nr. 10/2012, nenet 7.1.2, 7.1.7 dhe 7.1.8.

këtu edhe njoftimin e zyrave komunale për arritjen e paraparë të personave të riatdhesuar, kumtimin e vendimeve të Bordit për Riintegrim rreth kërkesave për ndihmë komunës përkatëse nëpërmjet koordinatoreve rajonalë, dhe kryerjen e vizitave në terren për të monitoruar riintegrimin e personave të riatdhesuar.²⁸ Fillimisht, komunikimi mes nivelit qendror dhe komunal ishte shumë i dobët, pa asnjë mekanizëm formal për bashkërendim.²⁹ Megjithatë, kjo u rregullua me Rregulloren nr. 10/2012, e cila përcakton emërimin e koordinatoreve rajonalë si pikë kontakti mes Zyrës për Riintegrim dhe komunave.

Sipas Rregullores nr. 10/2012, koordinatorët rajonalë janë përgjegjës për bashkërendimin e procesit të integritit në nivel komunal, si dhe për mbikëqyrjen e personave të riatdhesuar dhe për ofrimin e këshillave përkatëse për ata dhe për ZKKK-në. Ata gjithashtu janë përgjegjës për përpunimin dhe zbatimin e vendimeve të Bordit të Riintegritit dhe të MKK-së për rajonet e tyre gjegjëse, si dhe për mbikëqyrjen e tyre dhe raportimin në baza të rregullta pranë Departamentit të integritit të personave të riatdhesuar.³⁰

Zyra për Riintegrim ishte gjithashtu përgjegjëse për pritjen e personave të riatdhesuar në pikën e ripranimit. Duke qenë pika e parë e kontaktit për personat e riatdhesuar, ajo kishte për detyrë që të njoftonte ata për ndihmën dhe shërbimet e tjera në dispozicion duke përfshirë ndihmën mjekësore, sigurimin e strehimit deri në shtatë ditë dhe organizimin e transportit deri në komunën e prejardhjes.³¹

2.2 Niveli komunal

Sipas kornizës së viteve 2010/2012, bartësit kryesorë të përgjegjësisë në nivel komunal ishin ZKKK-të, që janë pikat kryesore për çështjet që kanë të bëjnë me kthimin në nivel komunal, dhe MKK-të që ka autoritetin për të përpunuar kërkesat për ndihmë emergjente, të tilla si pakot ushqimore dhe higjienike, orendi, strehim/banim dhe ndihmë mjekësore.

1) Zyrat komunale për komunitete dhe kthim

ZKKK janë mekanizma të detyrueshëm për mbrojtjen e komuniteteve në nivel komunal që shërbejnë si pika kryesore kontakti për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet dhe kthimin. Detyrimet e tyre burojnë kryesisht nga Rregullorja 02/2010 për ZKKK që përcakton në hollësi përbërjen dhe përgjegjësitë e tyre. Zyrat duhet të kenë Shefin e zyrës dhe dy koordinatore: një për kthim dhe një për komunitete dhe ky personel bazë më pas mund të ndihmohet nga disa zyrtarë sipas nevojës.³² ZKKK janë përgjegjëse, ndër të tjera, për vlerësimin e nevojave të personave të kthyer dhe të riatdhesuar; organizimin e vizitave; promovimin e ndërgjegjësimit për politikën ekzistuese ndër zyrtarët përkatës dhe përfaqësuesit e komuniteteve; lehtësimin e qasjes në shërbime publike, si dhe për hartimin, zbatimin

²⁸ Rregullorja 10/2012, Nenet 7.1.6, 7.1.11, 7.1.13 dhe 7.3.2.

²⁹ Raporti për Riatdhesim 2011, f. 11–13.

³⁰ Neni 7 i Rregullores nr. 10/2012.

³¹ Nenet 3.4 dhe 1.5 të Rregullores nr. 10/2012.

³² Nenet 3, 5 dhe 6 të Rregullores nr. 02/2010.

dhe mbikëqyrjen e projekteve dhe veprimtarive në dobi të personave të riatdhesuar. Për më tepër, është përgjegjësi e ZKKK që t'ju jap personave të riatdhesuar informata për të drejtat e tyre dhe për strukturat mbështetëse dhe ndihmën në dispozicion, si dhe për t'i referuar ata tek zyrat e tjera kompetente në kuadër të administratës komunale.³³ Përveç detyrimeve të përgjithshme të ZKKK-ve të përcaktuara me anë të rregullores nr. 02/2010, Rregullorja nr. 10/2012 përcakton në hollësi përgjegjësitë shtesë në kontekst të programit të riintegrit. Këto përgjegjësi kryesisht kanë të bëjnë me ndarjen e ndihmës për riintegrim dhe përfshin detyrimet për të ndërgjegjësuar personat e riatdhesuar për ndihmën në dispozicion, për t'i ndihmuar ata në plotësimin dhe dorëzimin e kërkesave, për të dorëzuar kërkesat në ZKKK apo në zyrën për riintegrim, si dhe për të mbikëqyruar zbatimin e vendimeve në bashkëpunim me koordinatorët rajonal.³⁴ Rregullorja nr. 10/2012 gjithashtu nënvizon përgjegjësitë ekzistuese të ZKKK për të vizituar personat e riatdhesuar dhe për të lehtësuar qasjen e tyre në shërbime publike duke përfshirë ato shëndetësore dhe të mirëqenies sociale.³⁵ Përveç detyrimeve³⁶ të tyre të përgjithshme për të raportuar në përputhje me Rregulloren nr. 02/2010, ZKKK-ve për më tepër iu caktua detyra për të dorëzuar raporte “të rregullta” pranë zyrës së riintegrit.³⁷

2) Komisionet komunale për riintegrim

Në përpjekje për të trajtuar problemin e vonesave të gjata në procesin e miratimeve, Rregullorja nr. 10/2012 lejonte decentralizimin e pjesshëm të fondit të riintegrit në nivel komunal, përmes themelimit të komisioneve të detyrueshme për riintegrim apo KKR. Këto komisione themelohen nga Kryetari i komunës³⁸ dhe përbëhen nga përfaqësuesit e drejtorive komunale përkatëse.³⁹ Ato kishin përgjegjësinë kryesore për miratimin e të gjitha kërkesave që ishin jashtë fushëveprimit të Bordit të Riintegrit (p.sh., të gjitha kërkesat, përveç atyre për [ri]ndërtim të shtëpive dhe ndihmë për gjenerimin të ardhurave), sidomos për pako ushqimore dhe të higjienës, orëdi, strehim/banim, ndihmë mjekësore si dhe ndihmë tjetër materiale. KKR-ve u kërkohej që të siguronin ndihmën e miratuar brenda shtatë ditëve.⁴⁰

KKR ishin po ashtu përgjegjëse për “identifikimin e nevojave të personave të riatdhesuar [...] lidhur me organizimin e kurseve shtesë të gjuhës, lehtësimin e qasjes së tyre në arsim, identifikimin e mundësive për trajnime profesionale dhe qasje në tregun e punës”. Ajo çka duhet të theksohet është se në këtë rast ka një lloj

³³ Neni 7 i Rregullores nr. 02/2010.

³⁴ Nenet 5.1.1, 5.1.2, 5.1.3, 5.1.4 dhe 5.1.6. të Rregullores 10/2012.

³⁵ Neni 5.1.8 i Rregullores nr. 10/2012.

³⁶ Obligimet e përgjithshme të ZKK-ve për të raportuar janë paraqitur të detajuara në raportin e OSBE-së të titulluar “*Vlerësim i procesit të kthimit vullnetar në Kosovë*”, i publikuar në muajin tetor 2012. <http://www.osce.org/sq/kosovo/96806> (çasur më 30 shtator 2013), faqe 11-13.

³⁷ Nenet 5.1.5 dhe 5.2 të Rregullores nr. 10/2012.

³⁸ Neni 6.1 i Rregullores nr. 10/2012.

³⁹ Këto janë të renditura si në vijim: përfaqësuesit për arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, punë dhe punësim, shërbime publike, planifikim hapësinor dhe urbanizëm, gjeodezi, kadastër dhe pronë. Zyrtari për integrim evropian gjithashtu duhet të jetë i pranishëm dhe përfaqësuesit e organeve të tjera komunale mund të ftohen për të marrë pjesë në mbledhje të caktuara varësisht nga nevoja. Rregullorja po ashtu cek një “zyrtar për riintegrim”, por është e paqartë nëse ky/kjo është anëtar i ZKKK apo është koordinatori rajonal. Neni 6.2 i Rregullores nr. 10/2012.

⁴⁰ Neni 6.6 i Rregullores nr. 10/2012.

mbivendosje me rolin e ZKKK-ve (siç u shtjellua në pjesën 2.2.1 më sipër) dhe korniza e viteve 2010/2012 nuk përcakton modalitetet për bashkëpunim.


3. ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE POLITIKE NË NIVEL QENDROR DHE ATË KOMUNAL

Në këtë pjesë do të vlerësohet shkalla dhe efektiviteti i zbatimit të kornizës së viteve 2010/2012 gjatë periudhës së raportimit.

3.1 Niveli qendror

1) Bordi i riintegrit

Gjatë periudhës së raportimit, Bordi i riintegrit ka respektuar detyrimin e tij për t'u takuar së paku një herë në muaj duke mbajtur në përgjithësi 33 takime. Në mes korrikut të vitit 2011 dhe qershorit të vitit 2013, ai pranoi gjithsej 2,953 kërkesa, miratoi 1,910 të tilla (64.5 për qind) prej së cilave 136 ishin për (ri)ndërtim të shtëpive dhe 396 për ndihmë në gjenerimin e të ardhurave.⁴¹ Sidoqoftë deri në shtator të vitit 2013, u zbatuan vetëm 36 kërkesa të miratuara (26.5 për qind) për (ri)ndërtim ndërsa 100 të tjera ishin në pritje të zbatimit; siç u raportua, kjo ishte kështu për shkak të vonesave në procesin e tenderimit.⁴² Për dallim prej kësaj, shkalla e miratimit ishte shumë e lartë për kërkesat për gjenerim të ardhurave, pra 376 kërkesa të miratuara (95 për qind) ndonëse mungesa e zbatimit të mbikëqyrjes përbënte shqetësim.⁴³




⁴¹ Vëreni se deri në mes të vitit 2012, Bordi i riintegrit ka rishikuar të gjitha kërkesat për ndihmë ndërsa pas miratimit të Rregullores nr. 10/2012 ai rishikoi vetëm kërkesat për (ri)ndërtim të shtëpive dhe ndihmë për gjenerim të ardhurave. Prandaj këto të dhëna statistikore përqendrohen vetëm në dy kategoritë e fundit.

⁴² Intervistë personale me zyrtarin e Departamentit të integritit, Prishtinë/Priština, 11 shtator 2013.

⁴³ Të gjitha të dhënat janë marrë nga Departamenti i integritit, 14 tetor 2013.

Kërkesat e pranuar/miratuara për gjenerim të ardhurave dhe (ri)ndërtim të shtëpive (RN/NSH) nga Bordi i Riintegrit (2,953)



Përderisa përgjegjësitë kryesore të Bordit ishin të dyfishta – pra për të rishikuar kërkesat për ndihmë dhe për të mbikëqyrur zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave – ai u përqendrua pothuajse vetëm në atë të parën⁴⁴ duke lënë pas dore mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit në një mënyrë sistematike ose për të njoftuar qeverinë me përparimin e shënuar apo sfidat.⁴⁵ Në praktikë, këto përgjegjësi u morën përsipër nga MPB që mori udhëheqjen në hartimin e rregullores nr. 10/2012 dhe në nisjen e rishikimit të politikave dhe kornizës rregullore gjatë vitit 2013. MPB-ja është gjithashtu pika kryesore e kontaktit për organizatat ndërkombëtare dhe donatorët që punojnë në çështjet e riintegrit. Ky realitet praktik u pasqyrua në kornizën e re të vitit 2013 që ia transferoi MPB-së përgjegjësitë e Bordit të Riintegrit që kanë të bëjnë me politika (shih pjesën 4 më poshtë).

2) Zyra për riintegrim

Mes viteve 2011 dhe 2013, numri i personelit të punësuar në kuadër të Zyrës për Riintegrim u shtua nga 7 në 42.⁴⁶ Kjo përgjegjësi e shtuar u pasqyrua në kornizën e vitit 2013 që transformoi Zyrën për Riintegrim në Departament për integrim të Personave të Riadhesuar (në tekstin e mëtuajtshëm “Departamenti i integritit) (shih pjesën 4 më poshtë).

Në përgjithësi, zyra për riintegrim e kreu mirë punën gjatë periudhës së raportimit duke përmbushur përgjegjësitë e saja kryesore sipas kornizës së viteve 2010/2012. Në

⁴⁴ Intervistë personale me zyrtarin e projektit të binjakëzimit të BE-së, 30 gusht 2013.

⁴⁵ Intervistë personale me zyrtarin e projektit të binjakëzimit të BE-së, 30 gusht 2013; intervistë personale me zyrtarin e Departamentit të integritit, Prishtinë/Priştina, 11 shtator 2013.

⁴⁶ Trembëdhjetë prej tyre ishin femra duke përfshirë drejtoreshën.

dhjetor të vitit 2010, ajo themeloi zyrën pritëse në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës për të siguruar se personat e riatdhesuar pritëshin ashtu siç do të duhej pas arritjes së tyre. Në përputhje me përgjegjësitë e saja sipas kornizës së viteve 2010/2012, zyra pritëse regjistroi të dhënat personale të personave të riatdhesuar të sapo kthyer, i njoftoi ata për ndihmën në dispozicion duke përfshirë atë përmes fletëpalosjeve informative dhe iu siguroi atyre strehim të përkohshëm deri në shtatë ditë dhe transportim deri në komunën e tyre të prejardhjes.⁴⁷

Emërimi i punonjësve të rinj mundësoi një ndarje më efektive të përgjegjësive përmes themelimit të divizioneve të specializuara dhe pikave kontaktuese në lidhje me, ndër të tjera, mbledhjen e të dhënave, zyrën pritëse, organizatat ndërkombëtare, komunikimin ndërministror dhe raportimin. Zyra për Riintegrim i ofroi sekretariatit mbështetje të përgjithshme administrative dhe përmes koordinatoreve rajonal mbikëqyri zbatimin e vendimeve të Bordit të Riintegritit dhe KKR. Megjithatë ajo nuk ndërmori ndonjë rishikim paraprak të kërkesave për ndihmë, ashtu siç përcaktohej, duke besuar se kjo ishte përgjegjësi e veçantë e sekretariatit.

Sa i përket bashkërendimit mes nivelit qendror dhe atij komunal, ZKKK-të në përgjithësi pajtohen se emërimi i tetë koordinatoreve rajonal nga Zyra e Riintegritit në vitin 2012⁴⁸ kishte një ndikim pozitiv në komunikimin mes nivelit qendror dhe atij komunal.⁴⁹ Koordinatorët i kanë transmetuar rregullisht informata ZKKK për zhvillimet në nivelin qendror, e cila në anën tjetër njoftonte KKR dhe i përcillte kërkesat nga KKR tek Zyra për Riintegrim.

Zyra për Riintegrim raportoi se koordinorët rajonal ndërmorën veprimtari ndërgjegjësimi për personat e riatdhesuar për t'i njoftuar ata për ndihmën në dispozicion, ashtu siç përcaktohet me anë të Rregullores nr. 10/2012, por nuk ruajti të dhënat për numrin apo vendndodhjet e vizitave të tilla.⁵⁰ Në lidhje me përgjegjësitë e saja për mbledhjen e të dhënave, Zyra për Riintegrim mbledhi të dhëna statistikore të zbërthyer për personat e riatdhesuar nga zyra pritëse e që më pas i ruajti në një bazë të centralizuar elektronike të dhënave; megjithatë, ajo nuk grumbulloi të dhëna të ngjashme nga komunat.⁵¹

Përkundër këtyre përparimeve të dukshme në zbatimin e Rregullores nr. 2010/12, disa probleme të caktuara vazhduan: përderisa zyra për riintegrim pohonte se ZKKK u njoftuan për gjendjen e kërkesave përmes postës elektronike zyrtare dhe kopjeve të skanuara të vendimeve, 22 komuna theksuan vonesat e vazhdueshme në procesin e miratimit të kërkesave dhe informatat kthyese të pakompletuara mbi kërkesat e hedhura poshtë.⁵² ZKKK njashtu raportuan se nuk ishin në gjendje që të vlerësonin

⁴⁷ Intervistë personale me zyrtarin e Departamentit të integritit, 11 shtator 2013. Monitorimi i pavarur nga OSBE-ja gjatë periudhës së raportimit vërtetoi se zyra pritëse ishte e hapur dhe funksionale dhe se afishet informative dhe fletëpalosjet ishin vendosur gjithandej aeroportit.

⁴⁸ Tetë koordinorët rajonal u emëruan gjatë periudhës së raportimit dhe mbulojnë të gjitha rajonet e Kosovës.

⁴⁹ Vlerësim në terren i OSBE-së, i kryer mes 8 dhe 17 majit të vitit 2013, duke përfshirë takimet sy me sy me zyrtarët e ZKKK në 34 komuna (vlerësim në terren i OSBE-së), shih fusnotën 10 më sipër.

⁵⁰ Intervistë personale me zyrtarin e Departamentit të integritit, 11 shtator 2013.

⁵¹ Intervistë personale me zyrtarin e Departamentit të integritit, 11 shtator 2013.

⁵² Deçan/Dečane, Dragash/Dragaš, Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/KosovoPolje, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Gračanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik,

gjendjen/statusin e kërkesave duke qenë se nuk kishte asnjë mekanizëm të përcaktuar për përcjelljen e përparimit të tyre dhe se koordinatorët rajonal nuk i ofruan atyre asnjë dëshmi të pranimit të kërkesave, gjë e cila ishte shumë problematike në rast të vonesave apo kërkesave të humbura.

3.2 Niveli komunal

1) Zyrrat komunale për komunitete dhe kthim

ZKKK-të janë themeluar në 33 komuna të Kosovës.⁵³ Përderisa përbërja e ZKKK-ve është në përputhje me Rregulloren nr. 02/2010 dhe shtojcat e saj, vetëm 13 nga 33 komuna kanë plotësuar pozitat me pesë punonjës.

Në përgjithësi ZKKK-të respektojnë përgjegjësitë e tyre sipas kornizës për riintegrim. Siç përcaktohet me Rregulloren nr. 10/2012, ato i ofrojnë personave të riatdhesuar informata për ndihmën në dispozicion ndonëse komunikimi në përgjigje të kërkesës nga personi i riatdhesuar për ZKKK është më shpesh reagues sesa proaktiv. Ato gjithashtu ndihmojnë personat e riatdhesuar në plotësimin dhe dorëzimin e kërkesave, si dhe në dërgimin e kërkesave pranë KKR.⁵⁴ Disa komuna në veçanti kanë vendosur praktika të mira pune: për shembull në Fushë Kosovë, pas një vlerësimi të nevojave, ZKKK ka punuar me drejtorinë komunale për arsim dhe shoqërinë civile vendore për të regjistruar 20 fëmijë të riatdhesuar në kurset shtesë të gjuhës; dhe në Pejë e Podujevë, zyrtarët komunalë kryen vizita ndërgjegjësimi tek familjet e riatdhesuara për të vlerësuar kushtet e tyre të jetës dhe për t'i ndihmuar ato në plotësimin dhe dorëzimin e kërkesave për ndihmë.⁵⁵ ZKKK gjithashtu mbikëqyrin miratimin dhe shpërndarjen e ndihmës, si dhe përcjellën gjendjen në rastet e vonesave apo mospranimit të ndihmës. Sidoqoftë ajo çka duhet të theksohet është se atyre nuk u kërkohet që të përcjellin atë se si ndihma shpenzohet në të vërtetë; gjë e cila hap mundësinë për keqpërdorim e posaçërisht në rastin e kërkesave për gjenerim të ardhurave. Ajo çka është inkurajuese është se, gjatë periudhës së raportimit, disa ZKKK zbatuan disa projekte për personat e riatdhesuar e atë shpesh në bashkëpunim me KKR (shih pjesën 3.2 më poshtë).

Në lidhje me përgjegjësitë e tyre për raportim, 14 ZKKK⁵⁶ ose kanë hartuar raporte mujore për Zyrën e riintegrit, ose i kanë dërguar asaj një kopje të raporteve të tyre tremujore dhe/apo gjashtëmujore në përputhje me detyrimet e tyre për raportim të

Kamenicë/Kamenica, Klinë/Klina, Klokot/Kllokot, Mamuşa/Mamushë/Mamuşa, Parteş/Partesh, Ranilug/Ranillug, Pejë/Peć, Prizren, Rahovec/Orahovac, Štrpce/Shtërpçë, Suharekë/Suva Reka dhe Viti/Vitina. Vlerësim në terren i OSBE-së.

⁵³ Ato nuk janë themeluar në Malishevë/Mališevo, apo në Mitrovicë veriore/Mitrovicë. Megjithatë, ajo çka duhet të theksohet është se në Malishevë/Mališevo është një zyrtar për kthim i cili ka marrë përsipër disa përgjegjësi të ZKKK.

⁵⁴ Ndonëse kjo informatë është raportuar nga vetë OSBE-ja, ajo është mbështetur me veprimtari të rregullta monitorimi nga OSBE-ja.

⁵⁵ Monitorim në terren i OSBE-së.

⁵⁶ Të dhënat statistikore përfshijnë punën e zyrtarëve për kthim në Malishevë/Mališevo dhe Junik, të cilët kryejnë disa detyra të një ZKKK por ku ZKKK nuk janë të themeluara.

“rregullt”.⁵⁷ Për dallim prej tyre, tetë i raportuan Zyrës së riintegritit vetëm pas parashtrimit të kërkesës⁵⁸ përderisa 11 ZKKK e tjera nuk kanë dorëzuar asnjë raport të vetëm.⁵⁹ Ajo çka duhet të theksohet është se, megjithatë, Zyra për riintegrim nuk kërkon raporte të tilla nga ZKKK me besimin se ato janë të dobisë së kufizuar; në vend të kësaj, ajo kërkon azhurnime të *atypëratyshme* për çështje të veçanta.⁶⁰

Përkundër kësaj pasqyre përgjithësisht pozitive, problem serioz dhe i qëndrueshëm vazhdon të jetë mungesa e vazhdueshme e të dhënave të besueshme dhe sistematike për personat e riatdhesuar, kryesisht për shkak se informatat e mbledhura dhe metodologjia e përdorur dallojnë nga komuna në komunë, me çrast shumica e tyre kanë mbledhur të dhëna vetëm rreth familjeve dhe individëve të cilët u janë drejtuar ZKKK-ve. Ky problem është nënvizuar edhe në raportin për riatdhesim të vitit 2011.⁶¹ Zyra për Riintegrim ka bërë disa përpjekje për të trajtuar këtë çështje përmes zhvillimit të bazës së centralizuar të të dhënave për riintegrim e cila është e shfrytëzueshme që nga muaji shtator 2013, sidoqoftë ishte tepër herët për të vlerësuar nëse ajo po përdorej në mënyrë efektive nga komunat dhe niveli qendror, dhe për shkak se të dhënat e zberthyera për këtë çështje nuk ishin vënë në dispozicion nga Zyra për Riintegrim.

2) Komisionet komunale për riintegrim

KKR janë themeluar në 33 komuna.⁶² Ndonëse 24 prej tyre i përmbahen përbërjes së përcaktuar me anë të Rregullores nr. 10/2012, nëntë prej tyre nuk i kanë në përbërje përfaqësuesit nga një apo më shumë ministri gjegjëse.⁶³ Për më tepër, gjersa përbërja zyrtare e KKR është kryesisht në përputhje me kushtet e përcaktuara me anë të Rregullores nr. 10/2012, disa komuna raportuan për shkallë të ulët të pjesëmarrjes që ndikon negativisht në cilësinë e diskutimeve dhe në procesin e përgjithshëm të vendimmarrjes.⁶⁴

Të gjitha KKR-të kanë kryer detyrën e tyre kryesore të shqyrtimit të kërkesave për ndihmë. Sipas të dhënave të mbledhura nga OSBE-ja, mes muajit korrik të vitit 2011 dhe muajit qershor të vitit 2013, KKR pranuan gjithsej 3,657⁶⁵ kërkesa, prej së cilave 376 ishin për banim a strehim, 32 për ndihmë mjekësore, 581 për orendi dhe dru zjarri

⁵⁷ Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/KosovoPolje, Gjilan/Gnjilane, Gračanica/Graçanicë, Junik, Klinë/Klina, Mitrovicë/Mitrovica, Novobërdë/NovoBrdo, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština, Ranilug/Ranillug, Shtime/Štimlje, Skenderaj/Srbica dhe Suharekë/Suva Reka.

⁵⁸ Gjakovë/Djakovica, Hani i Elezit/Elez Han, Istog/Istok, Kaçanik/Kaçanik, Kamenicë/Kamenica, Obiliq/Obilic, Štrpce/Shtërpce dhe Viti/Vitina.

⁵⁹ Dragash/Dragaš, Glogovac/Glogovac, Klokot/Kllokot, Lipjan/Lipljan, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Parteš/Partesh, Podujevë/Podujevo, Prizren, Rahovec/Orahovac, Shtime/Štimlje, Vushtrri/Vučitrn.

⁶⁰ Intervistë personale me zyrtarin e Departamentit të integritit, 11 shtator 2013.

⁶¹ Raporti për riatdhesim i vitit 2011, f. 13–14.


⁶² Ajo nuk është themeluar në severna Mitrovica/Mitrovicën e veriut.

⁶³ Këto janë Gračanica/Graçanicë, Hani i Elezit/Elez Han, Lipjan/Lipljan, Mamuşa/Mamushë/Mamuša, Obiliq/Obilic, Parteš/Partesh, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac, Shtime/Štimlje.

⁶⁴ Për shembull, në Prizren vetëm 3 nga gjithsej 11 anëtarë morën pjesë në takimin e datës 15 gusht 2013.

⁶⁵ Të dhënat lidhur me llojin e ndihmës nuk ishin në dispozicion për 1,138 kërkesa, kryesisht në rajonin e Pejës/Peć.

si dhe 1,531 për artikuj ushqimor dhe joushqimor.⁶⁶ KKR gjithashtu shoshiti 580 kërkesa për ndihmë në gjenerimin e të ardhurave dhe 230 kërkesa për ndërtim të shtëpive, para se ato të dorëzoheshin pranë nivelit qendror për miratim përfundimtar në pajtim me dispozitat e Rregullores nr. 10/2012. Nga 3,657 kërkesa të paraqitura, KKR-të miratuan 2,924 (gati 80 për qind). Sa i përket llojit të ndihmës, zbërthimi i kërkesave ishte si në vijim: 327 kërkesa ishin për banim a strehim (11 për qind), 30 për ndihmë mjekësore (1 për qind), 470 për orendi dhe dru zjarri (16 për qind), si dhe 1,946 për artikuj ushqimor dhe joushqimor (66.6 për qind).⁶⁷ Megjithatë KKR-të shpesh kanë dështuar që të sigurojnë ndihmën brenda afatit kohor të detyrueshëm prej shtatë ditëve, duke mbajtur takime mujore a dymujore për shkak, siç u raportua, numrit të ulët të kërkesave të paraqitura.



Megjithatë, niveli i respektimit të përgjegjësive të tyre nga ana e KKR-ve për të vlerësuar nevojat e personave të riatdhesuar ishte dukshëm më i ulët krahasuar me punën e bërë nga ZKKK-të. Domethënë, vetëm dhjetë KKR janë angazhuar në veprimtari të ndërgjegjësimit⁶⁸ kurse pjesa tjetër u mbështet në vlerësimet e bëra nga ZKKK⁶⁹-të. Për më tepër, KKR-të takohen vetëm për të miratuar kërkesat dhe nuk diskutojnë format e tjera të ndihmës (p.sh., kurset shitesë të gjuhës, përkrahje për

⁶⁶ Vëreni se kërkesat shpesh ishin dorëzuar dhe shqyrtuar nga ZKKK/KKR për pako, për shembull për strehim, dru zjarri dhe artikuj ushqimor dhe joushqimor. Sidoqoftë me qëllim të paraqitjes më të qartë të llojit të ndihmës së ofruar, të dhënat e lartcekura trajtojnë çdo kërkesë veç e veç, pra një pako ku kërkohet ushqimi, orenditë dhe artikujt ushqimor dhe joushqimor u trajtua si tri kërkesa të veçanta.

⁶⁷ Të dhënat nuk ishin në dispozicion për 151 kërkesa (5 për qind).

⁶⁸ Këto janë: Deçan/Dečane, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Gjilan/Gnjilane, Istog/Istok Kačanik/Kačanič, Klinë/Klina, Parteš/Partesh, Pejë/Peć dhe Ranilug/Ranillug. Për shembull, në Ferizaj/Uroševac KKR rregullisht organizoi veprimtari ndërgjegjësimit dhe ndërmori veprime të menjëhershme për të regjistruar fëmijët e moshës së shkollimit në sistemin arsimor, madje në pritje të vërtetimit të dokumentacionit të tyre.

⁶⁹ Të gjitha ZKKK-të e shqyrtuara kanë bërë vlerësim të nevojave të personave të riatdhesuar.

punësim, etj.). Mirëpo shenjë inkurajuese është se gjashtë KKR⁷⁰ bashkëpunuan me ZKKK për të zbatuar projekte në dobi të personave të riatdhesuar.

3) Nismat e përbashkëta ZKKK-KKR

Mes korrikut 2011 dhe qershorit 2013, ZKKK dhe KKR në tetë nga 34 komuna hartuan dhe zbatuan nismat e tyre në mbështetje të procesit të riintegritimit: dy komuna siguruan orë mësimi shtesë për fëmijët e riatdhesuar,⁷¹ një komunë zbatoi një vendim për të lehtësuar regjistrimin civil⁷² dhe pesë të tjera mbështeten punësimin e personit të riatdhesuar duke i siguruar trajnime profesionale apo duke i punësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë personat e riatdhesuar.⁷³ Komuna e Ferizajt, në veçanti, është një shembull i praktikave të mira. Përveç politikës së lartcekur të regjistrimit pa pagesë të personave të riatdhesuar, KKR njashtu nxori deklarata në një televizion lokal për të ngritur vetëdijësimin e personave të riatdhesuar për shërbimet dhe ndihmën në dispozicion të tyre sipas programit të riintegritimit. Ai ndërmori vizita të ndërgjegjësimit për t'u takuar me personat, për t'i njoftuar ata për të drejtat dhe shërbimet që u takonin atyre dhe inkurajoi regjistrimin në qendrën komunale të punësimit. KKR gjithashtu punoi me institucionet komunale të kujdesit shëndetësor për të siguruar se personat e riatdhesuar do të përjashtohen nga pagesa e shërbimeve shëndetësore. Komuna e Novobërdës është një shembull tjetër i praktikave të mira, ku komuna zbatoi një skemë punësimi për personat e riatdhesuar, ndihmoi personat e riatdhesuar në qasjen në regjistrimin civil dhe me mbështetjen e OSBE-së prodhoi/shpërndau fletëpalosje informative për shërbimet dhe ndihmën për riintegrim në dispozicion.

3.3 Përmbledhje e gjetjeve

Raporti për riatdhesim i botuar nga OSBE-ja në shtator të vitit 2011 identifikoi një numër të sfidave që ndikonin në integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, duke nënvizuar në veçanti mungesën e roleve institucionale të përkufizuara në mënyrë të qartë dhe bashkërendimin shumë të dobët mes nivelit qendror dhe atij komunal.⁷⁴ Në atë raport pohohej se kjo kishte kontribuar në ndërgjegjësimit dhe përkushtimin e ulët komunal për të zbatuar kornizën e politikave

⁷⁰ Këtu përfshihen Istog/Istok, Deçan/Deçane, Gjakovë/Đakovica, Obiliq/Obilić, Lipjan/Lipljan dhe Ferizaj/Uroševac.

⁷¹ Këto ishin Fushë Kosova/Kosovo Polje and Obiliq/Obilić. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, ZKKK punoi bashkë me drejtorinë komunale për arsim dhe organizatat e shoqërisë civile për të identifikuar 20 fëmijë të riatdhesuar të cilët kishin nevojë për orë mësimi shtesë; më pas, drejtoria komunale e arsimit organizoi një kurs të gjuhës që zgjati gjashtë javë. KKR gjithashtu i kërkoi ZKKK që të inkurajojë të gjitha familjet e riatdhesuara që të regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollë, edhe pse dokumentacioni i nevojshëm nuk ishte në dispozicion.

⁷² Kjo ishte komuna e Ferizajt/Uroševac, ndonëse duhet të theksohet se edhe komunat e tjera kanë siguruar në mënyrë të tërthortë regjistrimin civil falas për personat e riatdhesuar, pjesëtarë të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian të Kosovës përmes respektimit të udhëzimit administrativ të nivelit qendror që mëton zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë, 2009-2013.

⁷³ Në NovoBrdo/Novobërdë, komuna zbatoi një skemë punësimi për personat e riatdhesuar ndërsa shefat e ZKKK në Kamenicë/Kamenica, Partes/Partesh, Ranilug/Ranillug dhe Glogovc/Glogovac raportuan punësimin e disa personave të riatdhesuar përmes kontratave të përkohshme të punësimit dhe punëve të tjera publike (nuk ka të dhëna të sakta).

⁷⁴ Raporti për riatdhesim i vitit 2011, f. 18.

dhe ligjore, ndërsa procesi i stërzgatur i miratimeve nga lart poshtë do të thoshte se ndihma e riintegrit nuk u ofrohej shpejtë përfituesve.

Që nga viti 2011, bartësit kryesor të detyrës kanë shënuar përparim të konsiderueshëm drejt trajtimit të shqetësimeve të identifikuar në rekomandimet kyçe të raportit të vitit 2011. MPB-ja ndërmoi veprime vendimtare për të ripërtërirë zotimet e përvijuara në Strategjinë e rishikuar dhe planin e veprimit për vitin 2010 dhe ndau burimet e nevojshme për zbatimin e tyre përmes hartimit dhe miratimit të Rregullores nr. 10/2012 dhe ripërtëritjes vjetore të fondit të nivelit qendror për riintegrim (Rekomandimi 1⁷⁵).⁷⁶ Rregullorja nr. 10/2012 sqaroi marrëdhëniet mes organeve të ndryshme duke plotësuar kornizën institucionale dhe duke trajtuar vonesat e stërzgatura nga autoriteti decentralizues për ndihmën emergjente përmes themelimit të KKR. Kjo jo vetëm që ka rritur shkallën e dhënies së ndihmës emergjente në veçanti (shih pjesën 3.2.2 më lart), por ka institucionalizuar një forum për komunikim dhe bashkërendim mes zyrave dhe drejtorive përkatëse komunale (Rekomandimi 5⁷⁷). Ajo gjithashtu ka vendosur pozitën e Koordinatorëve Rajonalë për të përforcuar bashkëpunimin mes nivelit qendror dhe atij komunal, gjë që ZKKK-të raportojnë të ketë avancuar bashkërendimit dhe të ketë përmirësuar shkallën dhe cilësinë e rrjedhës vertikale të informatave (Rekomandimi 4⁷⁸). Institucionet qendrore tashmë njoftojnë paraprakisht komunat për arritjen e personave të riatdhesuar (Rekomandimi 2⁷⁹), si dhe kanë punuar me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë këtu OSBE-në dhe UNHCR-në, për të ofruar trajnime dhe seanca për ndërtim kapacitetesh të institucioneve lokale për të rritur vetëdijen për politikën dhe programet e riintegrit (Rekomandimi 3⁸⁰).⁸¹

⁷⁵ Rekomandimi nr. 1: “Të ripërtërihen zotimet e përcaktuara në Strategjinë e rishikuar dhe Planin e veprimit duke siguruar që burimet adekuate të jenë në dispozicion në të gjitha nivelet e qeverisjes, duke vënë theks mbi zyrat e posa-themelura komunale për komunitete dhe kthim, në bashkëpunim të ngushtë me komunat, si dhe mbi zbatimin e programeve dhe projekteve që kanë për cak fushat kyçe siç janë: regjistrimi civil, shëndetësia, arsimi, punësimi dhe banimi”. Raporti i vitit 2011 për riatdhesim, f.18.

⁷⁶ Një buxhet në shumë prej 500,000 EUR u nda për Fondin e riintegrit në vitin 2010; 3,420,150 EUR në vitin 2011; 3,170.150 EUR në vitin 2012; dhe e njëjta shumë prapë në vitin 2013. Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë, f. 10, fusnota 10 më sipër.

⁷⁷ Rekomandimi 5: “Në pajtim me Strategjinë e rishikuar dhe planin e veprimit, të sigurohet bashkëpunim, bashkërendim dhe komunikim efektiv ndërmjet zyrave dhe drejtorive përkatëse komunale dhe institucioneve të nivelit qendror dhe në mënyrë proaktive të kërkojnë informata dhe mbështetje nga ministritë përkatëse në lidhje me përgjegjësitë komunale”. Raporti për riatdhesim 2011, f. 19 (theksi i shtuar).

⁷⁸ Rekomandimi 4: “Të sigurohet bashkëpunim dhe bashkërendim efektiv ndërmjet ministrive përkatëse përgjegjëse për shëndetësi, arsim, punësim, mirëqenie sociale dhe banim, si dhe ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, duke forcuar kështu mekanizmat për bashkërendim dhe komunikim ndërministror” (theksi i shtuar). Raporti për riatdhesim 2011, f. 19.

⁷⁹ Rekomandimi 2: “Të ndërmerren hapat e mëtejme për të siguruar që komunat informohen në mënyrë sistematike dhe në kohë lidhur me ardhjen e personave të riatdhesuar, fushën e tyre të përgjegjësisë dhe procedurat që duhet të ndiqen kur aplikojnë për fonde të riintegrit, të cilat ndahen nga pushteti qendror”. Raporti për riatdhesim 2011, f. 19.

⁸⁰ Rekomandimi 3: “Në bashkëpunim me hisedarët përkatës ndërkombëtarë, të sigurohet trajnim dhe ngritje e mëtejme e kapaciteteve institucioneve lokale për shtimin e aktiviteteve për informim, aktiviteteve informuese dhe sensibilizimi në lidhje me politikën, strategjitë dhe programet ekzistuese për riintegrim, si dhe të mbështeten komunat në ngritjen e vetëdijes dhe shpërndarjen e informatave mbi të drejtat e personave të riatdhesuar dhe ndihmës në dispozicion”. Raporti për riatdhesim 2011, f. 19.

⁸¹ OSBE punon rregullisht me MPB-në në zbatim të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të përforcimit të përputhshmërisë së komunave me obligimet përkatëse nga politikën. Për shembull, në prill të vitit 2013, OSBE-ja pati mundësuar një punëtorë dy-ditore për të trajnuar zyrtarët komunalë

Përkundër këtyre përmirësimeve të mirëpritura, një numër rekomandimesh të rëndësishme nga raporti për riatdhesimin i vitit 2011 mbeten të patrajtuar. Me përjashtimet e dukshme të identifikuar në pikën 3.2.3 si më lart, shumë komuna vazhdojnë të jenë reaguese në qasjen e tyre ndaj ndihmës, si dhe nuk kanë vizita të rregullta tek personat e riatdhesuar për të identifikuar nevojat e tyre në terren, apo që t'i informojnë ata për ndihmën në dispozicion (Rekomandimi 9⁸²); aty ku këto aktivitete raportohen të ndodhin, nuk ka ndonjë regjistrim të numrit të tyre, apo ndonjë veprimi pasues. Mungesa e një vlerësimi sistematik nevojash do të thotë që komunat nuk mund të identifikojnë nevojat më urgjente dhe të prioritetizojnë aktivitetet e tyre sipas tyre (Rekomandimi 6⁸³).

4. RISHIKIMI I KORNIZËS SË RIINTEGRIMIT MË 2013

Siç theksohet më lart, në shkurt të vitit 2013, MPB-ja kishte filluar një rishikim të kornizës së politikave dhe asaj rregullative për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Më 6 shtator 2013, Rregullorja 10/2012 për menaxhimin e programit të riintegrimit ishte shfuqizuar me Rregulloren 20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit⁸⁴ (Rregullorja 20/2013), e cila kishte sjellë një numër ndryshimesh të rëndësishme institucionale e procedurale. Kjo u pasua me miratimin e një strategjie dhe plani të ri veprimi më 11 tetor 2013. Ndryshimet më të rëndësishme, si dhe efektshmëria e tyre e mundshme në trajtimin e problemeve të identifikuar, dokumentohen si më poshtë.

4.1 Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar 2013, si dhe Plan i Veprimit për zbatimin e saj

Për dallim nga Strategjia e rishikuar 2010, Strategjia për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë (Strategjia e Riintegrimit 2013) bën një analizë të shëndoshë – edhe pse të pabazuar në kuptimin sasior – të gjendjes aktuale të personave të riatdhesuar, duke përfshirë fushat kryesore të regjistrimit civil, shëndetësisë, banimit dhe arsimimit. Ajo riafirmon përkushtimin politik ndaj riintegrimit të suksesshëm të personave të riatdhesuar, duke e theksuar këtë si “një prej indikatorëve kryesorë për zhvillimin e qëndrueshëm në përgjithësi”.⁸⁵ Që në Deklaratën e Misionit thuhet që synimi është “krijimi i kushteve për riintegrim të qëndrueshëm përmes krijimit të mekanizmave plotësisht funksionalë dhe profesionalë për riintegrimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, dhe për garantimin e integritetit të

për raportimin e mirëfilltë dhe efektiv, si dhe grumbullimin sistematik të të dhënave. Në shtator të vitit 2013, OSBE-ja pati mundësuar një seri prej pesë tryezash të rrumbullakëta për të trajnuar zyrtarët komunalë për ndryshimet në procesin e riintegrimit, të cilat kanë lindur me miratimin e Rregullores 20/2013.

⁸² Rekomandimi 9: “Të organizohen aktivitete efektive informimi për personat e riatdhesuar, në mënyrë që të lehtësohet dhe mbështetet kontakti, dialogu dhe shpërndarja e informatave ndërmjet komuniteteve pranuese dhe të kthyerve si dhe ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve”. Raporti për riatdhesim 2011, f. 19.

⁸³ Rekomandimi 6: “Të identifikojnë nevojat më urgjente të personave të cilët kthehen në komunë, si dhe t'i përcaktojnë si duhet prioritetet e aktiviteteve të ndërlidhura, përfshirë përmes ndarjes urgjente të fondeve adekuate dhe veprimit të menjëhershëm mbi të gjitha aktivitetet që nuk janë buxhetuar”. Raporti i riatdhesimit 2011, f. 19.

⁸⁴ MPB, 13 gusht 2013.

⁸⁵ Strategjia për riintegrim 2013, f. 19.

plotë socio-ekonomik të qytetarëve që kthehen në Kosovë”.⁸⁶ Ajo gjithashtu specifikon tre objektiva strategjike, të cilat i elaboron përmes objektivave specifike si në vijim:

- 1) *Fuqizimi i kapaciteteve institucionale, instalimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit dhe decentralizimi i kompetencave*
 - i) Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore
 - ii) Funkcionalizimi i sistemeve të monitorimit e vlerësimit
 - iii) Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes akterëve relevantë të angazhuar në procesin e riintegrit
 - iv) Fuqizimi i komunikimit – këmbimi i informatave para dhe pas arritjes
 - v) Decentralizimi i kompetencave administrative dhe resurseve

- 2) *Hartimi dhe zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse në nivel lokal, për të arritur riintegrim të qëndrueshëm*
 - i) Zhvillimi i politikave të riintegrit në nivel lokal
 - ii) Ofrimi i shërbimeve të garantuara
 - iii) Përkrahja socio-ekonomike për riintegrim të qëndrueshëm

- 3) *Vetëdija publike dhe mobilizimi social*
 - i) Organizimi i fushatave të vetëdijesimit publik
 - ii) Angazhimi i shoqërisë civile në zbatim të projekteve, për një mobilizim social të qëndrueshëm.⁸⁷

Vënia në punë e një Sistemi për Menaxhimin e Rasteve (SMR), një bazë të dhënash elektronike të administruar nga MPB-ja, «ku regjistrohen, ruhen, procedohen dhe arkivohen kërkesat dhe të dhënat e tjera relevante lidhur me personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre»⁸⁸ është shumë inkurajuese. Nëse SMR-ja vihet në funksion deri në fund të vitit 2014, siç parashihet aktualisht në Plan të Veprimit, kjo do të vlente shumë në zgjidhjen e problemit të vazhdueshëm të statistikave joadekuate dhe inkonsistente për personat e riatdhesuar. Plani i Veprimit gjithashtu parashikon një «vlerësim të gjendjes aktuale» tek Objektivi 2.i, i cili do të trajtonte edhe sfidën e identifikuar të mungesës së vlerësimit sistematik të nevojave, si dhe zhvillimin e strategjive komunale e planeve të veprimit për integrim të personave të riatdhesuar, gjë që do të inkurajonte një qasje të strukturuar të ndërmarrjes së aktiviteteve në lidhje me riintegrimin.⁸⁹ Strategjia më tutje thekson që vëmendje e veçantë i duhet dhënë grupeve të cenueshme, duke përfshirë, mes tjerësh, nënat vetushqyese, të miturit pa përcjellje, personat e moshuar dhe komunitetet, e sidomos komunitetet romë, ashkali e egjiptian të Kosovës.

Derisa këto janë zhvillime shumë pozitive, duhet theksuar që Objektivi 2.ii (Ofrimi i shërbimeve të garantuara) fokusohet vetë, tek përgjegjësitë e nivelit qendror për të ofruar ndihmë të menjëhershme në arritje, për shembull transportimi deri tek komuna e destinimit dhe strehimi i përkohshëm, më shumë sesa tek obligimet afatgjate komunale për të garantuar qasje në të drejtat dhe shërbimet themelore, për shembull në lidhje me fushat problematike të arsimit, punësimit, politikave sociale dhe kujdesit

⁸⁶ Strategjia për riintegrim 2013, f. 13.

⁸⁷ Strategjia për riintegrim 2013, f. 13.

⁸⁸ Strategjia për riintegrim 2013, f. 23.

⁸⁹ Plani i Veprimit 2011, f. 12–13.

shëndetësor. Për më tepër, disa prej indikatorëve të Planit të Veprimit janë të mjegullt dhe të pamatshëm, si «Cilësia e shërbimeve» si dhe «Shërbimet e buxhetuara»,⁹⁰ të cilët do ta bëjnë të vështirë monitorimin e implementimit. Megjithatë, në përgjithësi, dokumentet janë përmirësuar në krahasim me Strategjinë dhe Planin e Veprimit të vitit 2010, si dhe zbatimi i tyre, bashkë me vlerësimin e tyre, duhen monitoruar me kujdes.

Derisa Strategjia për Riintegrim ofron një pasqyrë të kornizës përkatëse ligjore dhe institucionale, si dhe vijëzon përgjegjësitë themelore të ministrive përkatëse të linjës⁹¹, për dallim nga Strategjia e Rishikuar e vitit 2010, ajo (me të drejtë) ia lë hollësitë procedurale akteve nënligjore – në këtë rast Rregullores 20/2013.

4.2 Rregullorja 20/2013 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimin

Rregullorja 20/2013 shpërbën Bordin e Riintegrimin në nivel të lartë, si dhe bart përgjegjësinë për miratimin e kërkesave për (ri)ndërtim të shtëpive dhe gjenerim të ardhurave, bashkë me ndihmën mjekësore, tek Komisioni Qendror për Riintegrim (KQR); edhe përgjegjësitë e Bordit të Riintegrimin në lidhje me politikën i janë dhënë MPB-së. Ky ristrukturim synon të harmonizojë procesin e miratimeve, duke e transferuar barrën administrative për shqyrtim të kërkesave për banim dhe gjenerim të ardhurash nga një organ i lartë tek një komision në nivel pune.⁹² Rregullorja gjithashtu ka vendosur mekanizma të tjerë proceduralë me qëllim të përshpejtimin të procesit të miratimit, duke përfshirë edhe vendosjen e votimit të shumicës si dhe afatin 15-ditor për shqyrtim të kërkesave.⁹³

Edhe pse këto ndryshime janë gjerësisht pozitive, ende mbesin të paqarta disa çështje procedurale në lidhje me KQR-në e sapo themeluar. Derisa Rregullorja 20/2013 rendit ministritë pjesëmarrëse,⁹⁴ ajo nuk specifikon nivelin e përfaqësimit. Ajo gjithashtu nuk specifikon numrin e takimeve të KQR-së e as modalitetet për bashkëpunim institucional, për shembull mes KQR-së dhe Departamentit për Riintegrim së voni të zgjeruar (shih më poshtë). Për më tepër, derisa ajo përcakton afatin për miratimin e kërkesave, nuk përcakton ndonjë afat kohor për ofrimin e ndihmës.

Rregullorja 20/2013 gjithashtu provon të përforcojë implementimin e «masave të qëndrueshme» në përkrahje të riintegrimin, siç është rinovimi/rindërtimi i shtëpive,⁹⁵ kurset e gjuhës, aftësimi profesional, gjenerimi i të ardhurave, regjistrimi civil dhe

⁹⁰ Plani i Veprimit, f. 9 dhe 11.

⁹¹ MPB-ja, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal; Ministria e Diasporës; Ministria për Komunitete dhe Kthim; Ministria e Financave; si dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Strategjia për riintegrim 2013, f. 15–18.

⁹² Megjithatë duhet marrë parasysh që Rregullorja 20/2013 nuk specifikon nivelin e përfaqësimit në KQR.

⁹³ Rregullorja 20/2013, nenet 22.5 dhe 22.6.

⁹⁴ KQR-ja kryesohet nga MPB-ja, derisa anëtarët janë përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Rregullorja 20/2013, neni 22.

⁹⁵ Vëreni që korniza e re rregullative nuk lejon më ndërtimin e shtëpive të reja.

këshillimi.⁹⁶ Më me rëndësi, ajo largohet nga fokusi ekskluziv tek ofrimi i ndihmës së drejtpërdrejtë për persona të riatdhesuar tek ndihma indirekte, duke mundësuar që një pjesë e fondit t'i ndahet ministrive, komunave dhe organizatave të shoqërisë civile për implementim të projekteve afatmesme dhe afatgjata për përfitim të personave të riatdhesuar, siç janë orët plotësuese për gjuhë, projektet për krijim të të ardhurave, etj.⁹⁷ Përveç zgjerimit të mundësive për aplikues për fonde, rregullorja e re gjithashtu heq afatet për dorëzimin e kërkesave për ndihmë në arsim, aftësim profesional apo punësim, si dhe zgjat afatin për kërkesa për rindërtim të shtëpive dhe për vetëpunësim/themelim biznesi në 12 muaj (nga gjashtë muaj sipas Rregullores 10/2012).⁹⁸

Derisa korniza e periudhës 2010/2012 nuk parashihte ndonjë të drejtë ankimi, Rregullorja 20/2013 shprehimisht njeh këtë të drejtë⁹⁹ si dhe themelon një organ apeli për rishikim të vendimeve të KQR-së dhe Komisioneve Komunale për Riintegrim (më parë, Komitetet Komunale për Riintegrim).¹⁰⁰ Komisioni i ri i Ankesave përbëhet nga kryesuesi, zëvendës kryesuesi dhe tre anëtarë, ku të gjithë anëtarët duhet të jenë juristë me përvojë të «konsiderueshme» pune, derisa dy prej tyre duhet të kenë përvojë të lartë në fushën e riintegrit. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë, derisa pragu për kuorum është tre. Por, rregullorja e re nuk cek modalitetet procedurale për paraqitjen apo shqyrtimin e ankesave.

Korniza e re rregullative gjithashtu rishikon institucionet dhe procedurat ekzistuese për të marrë parasysh problemet e identifikuara. Ajo gjithashtu kërkon krijimin e një Sistemi për Menaxhimin e Rasteve, për të monitoruar kërkesat për ndihmë nga personat e riatdhesuar¹⁰¹ të cilat, siç theksohet më lart, është hap i parë themelor drejt zhvillimit të një qasjeje me bazë në evidenca ndaj ndarjes dhe vlerësimit të ndihmës. Ajo gjithashtu ngrit Zyrën e Riintegrit në nivel të Departamentit për Riintegrim, duke reflektuar kështu zgjerimin e saj të konsiderueshëm nga shtatë zyrtarë në vitin 2011 deri në 42 në vitin 2013, si dhe duke theksuar kështu më shumë përkushtimin politik ndaj procesit të riintegrit. Ajo kërkon edhe përfshirjen e përfaqësuesve të ZKKK-ve brenda KKR-ve, duke formalizuar kështu komunikimin dhe bashkërendimin në nivel komunal¹⁰², si dhe përforcon këtë bashkëpunim horizontal, duke obliguar Zyrat Komunale për Punësim, Qendrat për Aftësim Profesional, si dhe Koordinatorët Rajonalë që të monitorojnë dhe vlerësojnë implementimin e ndihmës në krijim të të ardhurave.¹⁰³

5. KONKLUDIME

Mes korrikut 2011 dhe qershorit 2013, institucionet përgjegjëse, veçanërisht MPB-ja, kanë qëndruar të përkushtuara ndaj procesit të riintegrit, siç edhe vërtetohet nga ndarja e vazhdueshme e resurseve të konsiderueshme njerëzore e financiare për institucione e aktivitete përkatëse. Zgjerimi i Zyrës së Riintegrit në Departament të

⁹⁶ Rregullorja 20/2013, neni 12.

⁹⁷ Rregullorja 20/2013, neni 32.7 dhe 32.8.

⁹⁸ Rregullorja 20/2013, neni 2.3 dhe 2.4.

⁹⁹ Rregullorja 20/2013, neni 33.1.3.

¹⁰⁰ Rregullorja 20/2013, neni 21.

¹⁰¹ Rregullorja 20/2013, neni 27.

¹⁰² Rregullorja 20/2013, neni 25.3.

¹⁰³ Rregullorja 20/2013, neni 17.7.

Riintegrimi është ilustrim i rëndësisë relative që i është dhënë menaxhimit efektiv të programit të riintegrit, ashtu siç është edhe ripërtëritja vjetore e Fondit të konsiderueshëm për Riintegrim. Përpjekjet e rregullta për rishikim të kornizës ligjore dhe politike gjithashtu kanë shfaqur përkushtimin e mirëfilltë ndaj adresimit të mangësive të identifikuara: Rregullorja 10/2012 provonte të zgjidhte problemin e vonësive të gjata në dhënien e ndihmës, duke decentralizuar disa kërkesa të caktuara tek niveli komunal, si dhe të përforconte bashkëpunimin e dobët mes nivelit qendror dhe komunal, përmes emërimit të Koordinatorëve rajonalë; në anën tjetër, Rregullorja 20/2013 vazhdoi përtej këtyre reformave duke ristrukturuar procesin qendror të miratimit, si dhe duke vendosur mekanizma të rinj proceduralë me qëllim të përshpejtimit të dinamikës së miratimeve. Ajo gjithashtu vendosi të drejtën e ankesës dhe mekanizmat përcjellës, për t'i mundësuar personave të riatdhesuar të drejtën e korrigjimit në rast se kërkesa e tyre refuzohet.

Një ndryshim thelbësor i futur me kornizën e vitit 2013 është edhe krijimi i një baze të dhënash shumë të nevojshme dhe gjatë të pritur, të centralizuar për personat e riatdhesuar – Sistemi i Menaxhimit të Rasteve. Siç theksohet më lart, një problem serioz dhe i vazhdueshëm në procesin e riintegrit ka qenë mungesa e vazhdueshme e të dhënave të besueshme, sistematike dhe të ndara për personat e riatdhesuar. Pa të dhëna të tilla nuk është e mundur të vlerësohet se sa persona (apo edhe familje) kanë qasje në banim, arsim dhe shërbime tjera themelore, sa prej tyre kanë gjetur punësim të qëndrueshëm – dhe as sa prej tyre ende qëndrojnë në Kosovë.¹⁰⁴ Palët përkatëse të interesit nuk kanë pasqyrë të qartë të demografisë së personave të riatdhesuar në Kosovë, si dhe nuk mund t'i përshtatin politikat dhe ndihmën për t'i plotësuar nevojat e tyre. Fondet e riintegrit mund të ndahen vetëm në baza reaktive, *ad hoc*. Kjo e bën planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë tejet të vështirë, si dhe nënkupton që çfarëdo lloj vlerësimi sasior i suksesit të politikave ekzistuese është gati i pamundur. Edhe pse MPB-ja ka ndërmarrë hapa më 2013 për të adresuar këtë problem, duke zhvilluar një bazë të dhënash të përbashkët për të gjitha komunat, është tepër herët të vlerësohet se sa komuna po përdorin këtë bazë të dhënash në zhvillimin dhe vlerësimin e politikave dhe projekteve. MPB-ja duhet të inkurajojë fuqimisht Departamentin e Riintegrit që të vë si prioritet grumbullimin e të dhënave nga komunat, si dhe të mbajë një Sistem Menaxhimi Rastesh të saktë dhe të besueshëm. Në anën tjetër, Departamenti për Riintegrim duhet të inkurajojë komunat që të përdorin të dhënat e grumbulluara për të ndërmarrë një vlerësim sasior nevojash, si dhe për të përcaktuar prioritetet e ndihmës ndaj rasteve më të cënueshme, si dhe për të kryer monitorimin dhe vlerësimin efektiv të implementimit.

Një zhvillim tjetër inkurajues është edhe zgjerimi i llojeve të ndihmës që ofrohen nga Fondi i Riintegrit. Derisa korniza e periudhës 2010/2012 kufizonte aplikuesit e mundshëm vetëm tek personat e riatdhesuar, duke kufizuar kështu shfrytëzimin e fondeve të riintegrit vetëm tek ndihma e drejtpërdrejtë, korniza e vitit 2013 e hap fondin për kërkesa nga palë të tjera për zbatimin e projekteve afatmesme dhe afatgjate për përfitim të personave të riatdhesuar, siç janë orët plotësuese të gjuhës, projektet e krijimit të të ardhurave, e kështu me radhë. Kjo ka zgjeruar masën e aplikuesve të mundshëm nga personat e riatdhesuar tek institucionet qendrore e komunale që punojnë në çështje të riintegrit, por edhe tek organizatat e shoqërisë civile, me

¹⁰⁴ DSHAM, që menaxhon të dhënat e migrimit, nuk përcjell nëse ata individë që riatdhesohen në Kosovë përfundimisht ikin prapë. Zyrtar, DCAM/MPB, intervistë personale, 4 shtator 2013.

implikime pozitive në qëndrueshmërinë e përgjithshme të procesit të riintegritit. Me adresimin e nevojave kolektive të personave të riatdhesuar përmes aktiviteteve të strukturuar, këto projekte të reja të riintegritit do të mund ta përmirësojnë qasjen në shërbime themelore për personat e riatdhesuar dhe të avancojnë qasjen e tyre në punësim të qëndrueshëm. Institucionet qendrore duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për ta rritur vetëdijësimin e partnerëve komunalë mbi këtë mundësi, duke shpërndarë ftesa për aplikime përmes kanaleve përkatëse. Në anën tjetër, institucionet komunale dhe aktorët relevantë të shoqërisë civile duhet të punojnë bashkë për t'i identifikuar nevojat e personave të riatdhesuar dhe në zhvillim të projekteve të synuara, me qëllim të adresimit të tyre efektiv.

Këto ndryshime pozitive shfaqin përkushtim të vazhdueshëm të institucioneve qendrore për të hequr mangësitë e identifikuara të mbrojtjes, si dhe për të promovuar riintegrimin e plotë të personave të riatdhesuar në shoqëri. Megjithatë, mbesin ende sfida, duke përfshirë mungesën e monitorimit dhe raportimit për implementimin e ndihmës, por edhe qasja kryesisht reaguese e komunave ndaj identifikimit të nevojave të personave të riatdhesuar dhe ofrimit të ndihmës në riintegrim. Për të zgjidhur këto çështje, institucionet qendrore duhet të inkurajojnë Koordinatorët Rajonalë që të punojnë afërsisht me ZKKK-të dhe palët tjera komunale për të monitoruar implementimin e kërkesave të miratuara, sidomos në lidhje me ndihmën në krijim të të ardhurave, orët plotësuese të gjuhës dhe rindërtimin/rinovimin e shtëpive, si dhe në dorëzimin e raporteve të rregullta mbi këtë çështje tek Departamenti i Riintegritit. Në anën e tyre, ZKKK-të duhet të kenë vizita të rregullta tek personat e riatdhesuar, në bashkëpunim me Koordinatorët Rajonalë dhe KKR-të, për të vlerësuar nevojat e tyre, për të rritur vetëdijen e tyre për ndihmën e mundshme, si dhe për t'i ndihmuar ata që ta marrin atë ndihmë.

6. REKOMANDIMET

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme

- Të nxirren udhëzues dhe procedura standarde të veprimit për zbatimin e Rregullores 20/2013 pa vonesë.
- Të vazhdohen përpjekjet në përkrahje të zhvillimit të politikave efektive, planifikim dhe orientim të riintegritit të personave të riatdhesuar, në pajtim me nenin 19.1.1 të Rregullores 20/2013.
- Të bëhen monitorime e vlerësime të rregullta cilësore e sasiore të gjendjes së zbatimit të kornizës ligjore dhe politike për riintegrimin e personave të riatdhesuar, në pajtim me nenin 19.1.2 të Rregullores 20/2013.
- Të sigurohet ndarja e vazhdueshme e fondeve adekuate për implementim efektiv të programit të riintegritit, në pajtim me nenin 19.1.2 të Rregullores 20/2013.
- Të shpallet ftesa e hapur për projekt-propozime në përfitim të personave të riatdhesuar, në pajtim me nenin 32.7 të Rregullores 20/2013, duke qartësuar mirë kriteret për pranimit dhe modalitetet e monitorimit e vlerësimit.

Për Komisionin Qendror për Riintegrim

- Të sigurohet që ministritë pjesëmarrëse të emërojnë përfaqësues të përshtatshëm, me ekspertizën dhe përvojën e duhur teknike për të vendosur mbi kërkesat në shqyrtim.

- Të sigurohet që bazat e refuzimit të kërkesave të arsyetohen në të gjitha vendimet, për të mundësuar ankesat sipas nenit 33.1.3 dhe 21 të Rregullores 20/2013.

Për Departamentin e Riintegritit

- Të kërkohet nga ZKKK-të të dorëzojnë të dhëna të sakta e të ndara për personat e riadhesuar në baza mujore, pa vonesë.
- Të merren hapa të menjëhershëm për t'i grumbulluar të dhënat komunale për personat e riadhesuar në një bazë qendrore e të harmonizuar të dhënash.
- Të analizohen të dhënat nga baza qendrore e të dhënave për t'u përdorur në hartimin dhe vlerësimin e politikave e projekteve që synojnë personat e riadhesuar.
- Të rritet vetëdija e institucioneve komunale dhe organizatave të shoqërisë civile që punojnë në çështje të riintegritit në lidhje me ftesat për propozime që shpallen nga MPB, përmes Koordinatorëve Rajonalë dhe faqes zyrtare të internetit.
- Të sigurohet që të gjitha vendimet e KQR-së të kthehen në komunën përkatëse përmes Koordinatorëve Rajonalë, në pajtim me nenin 6 të Rregullores 20/2013.
- Të kërkohen raporte të rregullta për zbatimin e vendimeve të KQR-së dhe KKR-ve nga Koordinatorët Rajonalë, duke përfshirë edhe ndihmën në krijimin e të ardhurave, rindërtimin e shtëpive dhe për orë plotësuese të gjuhës, në pajtim me nenin 31.2 dhe 17.7 të Rregullores 20/2013.

Për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim

- Të intensifikohen përpjekjet e komunikimit me personat e riadhesuar, në bashkëpunim me Koordinatorët Rajonalë, për t'i informuar ata për mekanizmat ekzistues të përkrahjes, si dhe për t'i identifikuar e prioritetizuar nevojat e tyre, në pajtim me nenin 24 të Rregullores 20/2013.
- Të vazhdohet ndihma për persona të riadhesuar në plotësimin dhe dorëzimin e kërkesave për ndihmë për riintegrim, në pajtim me nenin 24.2.1 dhe 24.2.3 të Rregullores 20/2013.
- Të mblidhen të dhëna të sakta, të ndara për personat e riadhesuar, në pajtim me nenin 7.2 të Rregullores 02/2010, për dorëzim tek niveli qendror.
- Të monitorohet zbatimi i vendimeve të KQR-së dhe KKR-së në bashkëpunim me Koordinatorët Rajonalë dhe palët tjera komunale, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me ndihmën në krijimin e të ardhurave, rindërtimin e shtëpive dhe për orët plotësuese të gjuhës, në pajtim me nenin 31.2 të Rregullores 20/2013, si dhe të dorëzohen raportet e rregullta tek Departamenti i Riintegritit përmes Koordinatorëve Rajonalë.
- Të merren veprime konkrete për përmirësim të bashkëpunimit horizontal me institucionet përkatëse komunale dhe organizatat e shoqërisë civile.

Për Komisionet Komunale për Riintegrim

- Të bashkëpunohet me ZKKK-të në vlerësim të nevojave të personave të riadhesuar, në pajtim me nenin 25.6 të Rregullores 20/2013, duke përfshirë edhe aktivitetet e komunikimit me personat e riadhesuar dhe analizat e të dhënave për personat e riadhesuar.
- Të sigurohet se mbahen shënime për vijimësi dhe procedurë për të gjitha takimet, si dhe që mungesa e vazhdueshme e institucioneve përkatëse

komunale t'i komunikohet Departamentit të Riintegritit përmes Koordinatorëve Rajonalë.

Për Zyrat Komunale të Punësimit, Qendrat e Aftësimit Profesional, si dhe koordinatorët rajonalë

- Të bëhen monitorime e vlerësime periodike të zbatimit dhe efikasitetit të ndihmës në krijimin e të ardhurave, si dhe të dorëzohen raporte të rregullta tek Departamenti i Riintegritit, në pajtim me nenin 17.7 të Rregullores 20/2013.

Për organizatat e shoqërisë civile që punojnë në çështje të riatdhesimit

- Të punohet me institucionet komunale dhe përfaqësuesit e komuniteteve për t'i identifikuar nevojat e personave të riatdhesuar, si dhe të zhvillohen e të dorëzohen projekt-propozime, me qëllim të adresimit të tyre tek Ministria e Punëve të Brendshme në përgjigje ndaj ftesave për propozime të hapura.